

V E N D I M
Nr.138, datë 22.3.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.301, DATË 14.6.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASAT E PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7698, DATË 15.4.1993, “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE””, TË NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.402, DATË 1.8.1994; NR.476, DATË 4.9.1995, NR.526, DATË 2.10.1995;DHE NR.234, DATË 22.5.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128, të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.301, datë 14.6.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “a” ndryshohet si vijon:

“a) Në të gjitha prefekturat, komisionet e kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve përbëhen nga 5 anëtarë, si më poshtë vijon:

1. Kryetarifunksionar

2. Nënkyetarijurist ose specialist, me arsim të lartë në fushën endërtimit

3. Specialisturbanist, inxhinier ose specialist me arsim të lartë

4. Specialisturbanist, inxhinier ose specialist me arsim të lartë

5. Specialistarkivist, sekretar me arsim të lartë

Emërimi dhe largimi nga detyra e kryetarit dhe i nënkryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, do të bëhet me propozimin e prefektit dhe me miratimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve.”.

- Shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“b) Emërimi dhe largimi nga detyra i anëtarëve të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, do të bëhet me propozimin e kryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, dhe me miratimin e prefektit.

Propozimet që paraqiten nga kryetarët e komisioneve të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, do të jenë propozime alternative me dy kandidatë.

Nëse Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve nuk vendos për emërimin e kandidaturave të paraqitura, atëherë procedura e emërimit fillon nga e para, me kandidatura të reja.”.

- Shkronja “ç” ndryshohet si vijon:

“ç) Të gjithë anëtarët e komisionit do të punojnë me shkëputje nga puna.

Paga e kryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të jetë sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, Lidhja I, B5.

Paga e nënkryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të jetë sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, Lidhja I, C2.

Paga e anëtarëve të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të jetë sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, Lidhja I, C3.”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal, prefekturat dhe Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta